



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/Republic of Kosovo
Komuna Dragash/ Opština Dragaš/Dragas Municipality
(Këshilli për Siguri në Bashkësi - Odbor Bezbednosti u Zajednici)



R A P O R T
I KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI, për vitin 2018
&
PLANI I VEPRIMIT, për vitin 2019

Dragash, 06.02.2019

R A P O R T I

i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, për vitin 2018

Pas konstitumit të Kuvendit të ri të Komunës së Dragashit, të dalë nga rezultati i zgjedhjeve lokale-2017, në seancën e Kuvendit Komunal të dt.22.2.2018 u themelua edhe Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi. Kështu, gjatë vitit kalendarik-2018, ky Këshill veproi duke u angazhuar konform obligimeve dhe kompetencave të parapara me Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi. Sipas këtij UA, konkretisht, nenit 4 të Udhëzimit të larpërmendur, në Këshill ishin të përfshirë përfaqësues të organeve komptente komunale dhe të subjekteve tjera të rëndësishme për aspektin e sigurisë në Komunë e më gjerë. Sipas obligimeve dhe kompetencave ligjore që i përkasin këtij Këshilli të Sigurisë, në Komunën tonë, për periudhën raportuese, u mbajtë 6 takime të rregullta, ashtu siç parashihet edhe konform me UA-e. Gjatë takimeve të organizuara, fatmirësisht, vazhdoi kontinuiteti i konstatimit se vazhdon gjendja stabile politike dhe e sigurisë në Komunën tonë e që, si e tillë, vlerësohej edhe për nivelin rajonal nga organet më të larta kompetente shtetërore për këtë sferë, si dhe monitoruesit të cilët përcillnin punën në takimet e rregullta të Këshillit. Një vlerësim e konstatim i këtyre bazohej në mardhëniet stabile ndëretnike në Komunë të përcjellur me lirinë e lëvizjes së qytetarëve në mbar teritorin e Komunës, kurse rastet e pa dëshiruara që kanë ndodhur kohë pas kohe, nuk kanë mundur të reflektohen në klimën e gjithmbarshme politike të sigurisë në të dy trevat e Komunës sonë-Opojës dhe Gorës. Prandaj, gëzon fakti se, si e këtyll, komuna e jonë është cilësuar edhe nëpër raportet e organeve më të larta të sigurisë në nivel të Rajonal dhe të mbar Republikës së Kosovës, apo edhe në takimet e organizuara nga: KFOR-i, OSCE-ja dhe organizatat tjera ndërkombëtare e vendore që interesoheshin dhe vëzhgonin çështjet e sigurisë te ne.

Gjatë 6 takimeve të organizuara - më 2018, ku u trajtuan 18 pika të rendit të ditës, si zakonisht, fillimisht, miratohej edhe Procesverbali nga takimi paraparak i Këshillit, analizohet gjendja e sigurisë në mes takimeve, me vlerësime gjenerale nga Kryesuesi i Këshillit (që, sipas funksionit është Kryetari i Komunës) dhe anëtarë tjerë, kurse Rezime, më konkrete të gjendjes së sigurisë bëhej, përmes raporteve mujore e periodike, nga ana e Komandantit të Stacionit Policor në Dragash. Edhe në këto raportime, parimisht, gjendja e sigurisë vlerësohej mjaft stabile dhe e klasifikuar sipas këtyre specifikave të ngjarjeve: vepra penale, vepra kundër cenimit pronës, lëndime të lehta trupore, aksidente trafiku dhe vepra të ndryshme kundërvajtëse (që të kualifikuara-si të tilla gjenden në evidentcat e Policisë...) dhe janë paraqitur tek organet e zbatimit të ligjit për procedurat të mëtejme në kualifikimin e tyre dhe ndërmarrjen e masave adekuate ligjore. Sipas statistikave të paraqitura në takimet e Këshillit..., rezulton se ka oscilime periodike të veprave, siç janë: veprat e natyrës penale, vjedhjet dhe dënimet në trafik, kurse ka zvogëlim të atyre kundërvajtëse dhe aksidentet në trafik. sipas tabelës në vijim:

Raporti vjetor i KKSBB 2017 -2018

| | 2017 | 2018 |
|-----------------------|------|------|
| Raste të Inicuar | 240 | 222 |
| Veprat Penale | 184 | 157 |
| Vjedhje | 20 | 15 |
| Vjedhje e rende | 25 | 20 |
| Aksidente të Trafikut | 38 | 31 |
| Dënime në Trafik | 3184 | 3624 |

Sipas kësaj gjendjeje, marr, në tërësi, konstatim i përgjithshëm i takimeve të Këshillit ishte se situata politike dhe e sigurisë ka qenë në nivel të kënaqshëm, me liri të plotë të lëvizjes së qytetarëve, funksionim normal të organeve komunale e shtetërore dhe pa ndonjë situatë e cila do të rëndonte dukshëm gjendjen e gjithmbarshme politike dhe rethanat e funksionimit normal të pushtetit lokal të ne.

Do theksuar se, në këto takime, pos anëtarëve të Këshillit, ka qenë prezente dhe e mirëpritur edhe pjesëmarrja e përfaqësuesëve të OSCE-së dhe të ministrive përkatëse-MBBrendshme të MAPL-së (që njoftoheshin për datën dhe me agjendën e takimeve), si dhe OJQ- të e mediat e interesuara. Ndërkaq, në frymën e tolerancës dhe mirëkuptimt, nga anëtarët dhe sugjerimeve të mysafirëve prezent në takime, inicoheshin edhe çështje tjera me interes për qytetarët, komunën dhe mbarvajtjen e punës së Këshillit, siç ishin:

- Përcjellja dhe ruajtja e përditshme e sigurisë, angazhimet lidhur me kalimet ilegale të kufirit në brezin kufitar dhe aktivitetet për parandalimin dhe zbulimin e tyre kishin trajtim permanent, duke u kërkuar angazhim më i madh i organeve të policisë me prokuroritë dhe gjykatat, për punë sa më efektive në parandalimin e tyre. Objekt trajtimi kanë qenë të gjitha dukuritë negative të cilat reflektohen në sferën e sigurisë së gjithmbarëshme në Komunë, përfshi këtu edhe parandalimin e substancave narkotike, nga të cilat nuk ka qenë immune as komuna jonë e që është informuar edhe opinioni i gjerë. Në këtë kontekst është edhe vendosja e kamerave të sigurisë në ato vende ku ishin paraparë me Projektin e UNDP-së, por që, ende, ka probleme për të funksionuar siç duhet dhe ku ishin paraparë,
 - Çështja e sigurisë në shkollë dhe respektimi i mësimit, me evitimin e ekscesive të mundëshme, kanë qenë tema për të cilat vazdimisht është informuar në raportimet e Policisë në Këshill e që, fatmirësisht, krahasuar me vitin paraprak, falë angazimit të mësidhënësëve, prindërëve, patrullimeve policore dhe vetëdijesimit të nxënësëve janë shënuar trende më pozitive se sa më parë, nga se ligjëratat e tilla vetëdijesuese në realacionin polici-shkollë ishin permanente,
- Thellimi i bashkëpunimit ndërkufitar të Komunës sonë me komunat kufitare të 2 shteteve për reth-Shqipërisë e Maqedonisë, përfshi këtu sidomos nevojën e funksionimit e zyrtarizimit të rrugëve e vendkalimeve adekuate kufitare, është parashtruar si dhe nevojën për koordinimin e aktiviteteve të përbashkëta dhe realizimi i projekteve me interes reciprok, ishin dhe ngelin çështje që do të përkraheshin edhe nga donatorët vendor e ndërkombëtar,
- Janë theksuar nevojat e bashkëpunimit të komunitetit me KKSBB-në dhe këshillat lokale të sigurisë (e që të ne, aktualisht, funksionon vetëm KLSB-së në Krushevë i cili KL, pos bashkëpunimit, është dëshmuar edhe me realizim të projekteve....), por që është synim edhe për në lokalitetet tjera të Komunës,
 - Njoftimet për sigurinë në trafik dhe angazhimet për rreptimin e rregullave dhe përmirësimi i kushteve nëpër rrugët tona, si dhe sinjalizimi i tyre me shenja adekuate trafiku në vendet kyçe, që llogaritet të vazhdohet edhe në të ardhmen përmes anagzhimeve të organeve inspektuese komunale dhe të Polisës së Kosovës,
 - Çështjet e respektimit të orareve të punës nëpër lokale afariste dhe ruajtja e rendit dhe qetësisë publike në to është konstatuar se këto dukuri sidomos janë evidente gjatë sezonit veror kur, zakonisht, në Komunë arrijnë kurbetçarët dhe shtohet fluksi i lëvizjes së tyre në trafik dhe vendet publike përmes organizimit të ahengjeve private, konsumimit të alkoolit, mosrespektimit të rregullave në trafik me tejkalime të shpejtësisë dhe ngarjen e veturave nën ndikim të alkoolit. Këto dukuri janë konsideruar se, shpesh-herë, kanë qenë shkaqe të drejtpërdrejta të prishjes së rendit e qetësisë publike e që shoqërohen edhe me ekscese dhe intervenime policore të cilat vepra kanë kërkuar edhe arrestime e dënime të cilat janë shqiptuar nga organet e rendit,

- Edhe mirëmbajtja e higjienës dhe ruajtja e ambientit kanë qenë dhe ngelin tema të cilat brengosin dhe kërkojnë angazhim edhe për të ardhmen, nga se ballafaqohemi me mungesë ndërgjegjeve dhe hedhje të pa kontrolluar të tyre dhe mos pagesën e obligimeve nga qytetarët tonë ndaj kompanisë "Hidro-Higjiena", që, në ardhmen, kërkon angazhim më të madh të shërbimeve të inspekcioneve, Policisë dhe gjykatave në shqiptimin e dënimeve ndaj personave dhe ndërmarrjeve të pandërgjegjësme të cilat i kontibuojnë ndotjes së ambientit me mbeturina shtëpiake dhe të ngurta, vend e pa vend, duke u krijuar deponi të shumëta ilegale te ne,
- Dukuria e cila është shqyrtuar dhe vlerësuar si brengosëse për t'u evituar ka qenë dhe mbetet problematika mjaft e shprehur e qenëve endacak e cila, edhe përkundër disa masave preventive që janë ndërmarrë, ka nevojë që të gjurmohet për zgjidhje në nivel komunal e më gjerë me forma sa më adekuate trajtimi, nga se numri i tyre vazhdimisht po shtohet-madje edhe sjelljen e tyre nga viset jasht komunës sonë. Viti i shkuar ka qenë vit i masave për evidentimin dhe shenjzimin e qenëve endacak nga veterinerët e angazhuar përmes Agjencisë së Veterinës së Kosovës dhe Komunës, por që enda ka ngel çështje e pa zgjidhur trajtimi i tyre - deri në fund, nga se për këtë Komuna nu ka kushte e kapacitete formale e që problematika kërkon angazhim në nivel vendi,
- Nga DEMSHpërtimit dhe Policia është referuar edhe për gjendjen në parandalimin e dukurive të zjarreve dhe zjarrvënieve gjatë verës, si dhe në mirëmbajtjen e rrugëve rajonale e lokale-sidos gjatë sezonit dimëror, që ka parashtruar nevojën e tenderimit dhe angazhimit të kompanisë nga MInfrastrukturës dhe Komuna, për mirëmbajtjen e tyre,
- Po ashtu, do përmendur se, në bashkëpunim me ICITAP-in amerikan, janë organizuar takime e aftësimi të 60 vijuesëve për veprime emergjente të sigurisë, si dhe nevoja e themelimit dhe funksionimit të KLSB-së nëpër fshtarat tona, në të cilin drejtim duhet motivuar e vetëdijesuar popullatën për ardhjen në shprehje vulluntarizmi i intervenimit për secilin rast emergjent të të secilit mjedis të komunës sonë,

Në funksion të komptencave dhe përgjegjësive, Këshilli ka shqyrtuar edhe çështje tjera që i ka imponuar momenti, apo që i kanë inicuar anëtarët e Këshillit dhe mysafirët prezent që kanë monitoruar dhe nderuar punën e Këshillit , me pjesëmarrje e tyre.

Andaj, në bazë të gjendjes së këtillë, rëndësisë së sigurisë dhe çështjeve për trajtim, për të ardhmen, nevojitet shtim i përgjegjësive, që secili subjekt komunal , organ shtetëror, apo edhe anëtarë i Këshillit, duke vepruara sipas dinamikës së punës së Këshillit dhe me përgjegjësisë së plotë në iniciimin e çështjeve dhe përmbushjen e obligimeve të parapara ligjore në sferën e sigurisë qytetare, në secilin mjedis të Komunës sonë.

Zyrtari-koordinator i Këshillit:

Azbi Halili

Kryesuesi i Këshillit :

Shaban Shabani, d.v.



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality

Në bazë të nenit 6.1 dhe 9.1.7 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 të MPB-së – 03/2012 MAPL-së për kompetencat dhe obligimet e këshillave komunale për siguri në bashkësi, KKSJ-ja në Dragash, në mbledhjen e mbajtur më 06.02.2019, miraton këtë :

PLAN TË VEPRIMIT

TË KKSJ-së DRAGASH, për vitin 2019

| Nr.rend. | Çështjet-temat për shqyrtim | Muaji | Shqyrton & miraton |
|----------|--|--------------------|---------------------------|
| 1. | <ul style="list-style-type: none">- Gjendja në trafikun rrugor gjatë sezonit dimëror,- Fillimi i gjysmëvjetorit shkollor dhe gjendja e sigurisë në shkolla | Janar-Prill/2019 | KKSJ-ja |
| 2. | <ul style="list-style-type: none">- Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit Vjetor-2018 dhe Planit të Veprimit 2019 të KKSJ-së,- Çështja politike dhe e sigurisë gjatë 3-mujorit parë-2019,- Shqyrtimi i mundësive për bashkëpunim ndërkufitar me projekte e vizita të përbashkëta | Shkurt-Prill/2019 | KKSJ-ja & Kuvendi Komunal |
| 3. | <ul style="list-style-type: none">- Çështja politike dhe e sigurisë gjatë 6-mujorit dhe sezonit pranveror ,- Njoftimi me problematikën e zjarreve dhe zjarrvënieve dhe ruajtjes së pyjeve në Komunë dhe shtimi i masave të sigurisë, për këtë,- Siguria në shkolla dhe mbarvajtja e mësimi,- Dukuria e kalimeve ilegale të kufirit dhe evitimi i vjedhjeve që reflektohen, veçmas në zonat kufitare | Maj-Qershor/2019 | KKSJ-ja |
| 4. | <ul style="list-style-type: none">- Çështja politike dhe e sigurisë gjatë 6-mujorit dhe në prag të fillimit të pushimeve verore dhe pritja e kurbetçarëve,- Njoftim me gjendjen-problematikën e qenëve endacak në Komunë dhe hapat e mëtejshëm,-Themelimi i KLSB-së në terren | Korrik-Gusht/2019 | KKSJ-ja |
| 5. | <ul style="list-style-type: none">- Çështja politike dhe e sigurisë gjatë 9-mujorit dhe në vigjile të fillimit të vitit të ri shkollor 2019/2020,- Njoftimi me gjendjen në trafik dhe siguria në punën e lokaleve gjatë sezonit veror të përcjellur me fluksin e kurbetçarëve gjatë pushimeve | Shtator-Tetor/2019 | KKSJ-ja |
| 6. | <ul style="list-style-type: none">- Çështja politike dhe e sigurisë me fundvitin 2019 dhe përgatitjet për sezonin dimëror,- Njoftim me përgatitjet dimërore të SHZSHSH Publike për mirëmbajtjen e rrugëve lokale gjatë sezonit dimëror | Nëntor-Djetor/2019 | KKSJ-ja & Kuvendi Komunal |

2.-

Vërejtje: Ky Plan i Veprimit për vitin 2019 i KKS-së për Komunën e Dragashit, krahas analizës-raportim të rregullt të kompetentëve reth gjendje së sigurisë në Komunë dhe çështjeve të parapara për shqyrtim sipas dinamikës së lartcekur, ngel i hapur edhe për çështje të tjera që do të inicoreshin nga vetë anëtarët e KKS-së, organet shtetërore e komunale, subjekte politike, OJQ-të dhe monitorues të punës së KKS-së, përfshi këtu edhe mundësinë e takimeve reth sigurisë me qytetarë nëpër lokalitete. Pa dyshim se iniciativat e tilla, eventuale, do të inkorporoheshin dhe do të ishin pjesë përbërëse e këtij Plani, për t'u shqyrtuar sipas dinamikës dhe momenteve që imponohen për rethanat e Komunës së Dragashit, me qëllimin kryesor rë mbarvajtjes së punëve nga aspekti i sigurisë në Komunë dhe më gjerë.

Zyrtari-koordinator i KKS-së:

Azbi Halili

Kryesuesi i KKS-së Dragash

Shaban Shabani, d.v.